

Informacione për pacientët për trajtimin e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave është subjekt i pëlqimit

Pëlqimi juaj vlen si për ambulancën dhe mjeket, mjekët e saj, terapeutet dhe terapeutët si dhe stafin mjekësor të saj (si përgjegjës), ashtu edhe për marrësit e përmendur në formularin e pëlqimit. Përderisa është e nevojshme për trajtimin, ky pëlqim vlen edhe si lirim nga sekretet profesional sipas nenit 321 StGB [Kodit Penal], nëse kjo kërkohet nga qëllimi mjekësor ose terapeutik. Pëlqimi juaj jepet për të gjithë trajtimin e të dhënave personale, pavarësisht nga mjetet dhe procedurat e përdorura, veçanërisht për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen, përdorimin, modifikimin, njoftimin, arkivimin, fshirjen ose asgjësimin e të dhënave.

Përgjegjësitë

Zyra përgjegjëse për përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe në veçanti të të dhënave tuaja shëndetësore është ambulanca. Në rast të pyetjeve për mbrojtjen e të dhënave ose nëse dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave, ju lutemi, drejtohuni drejtpërdrejt stafit të ambulancës ose mjekes/mjekut ose therapeutes suaj/therapeutit tuaj.

Mbledhja dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave

Përpunimi (mbledhja, regjistrimi, përdorimi si dhe ruajtja) e të dhënave tuaja bëhet në bazë të kontratës së trajtimit dhe të përcaktimeve ligjore për përmbushjen e qëllimit të trajtimit si dhe për detyrimet e lidhura me këtë. Në njëërën anë, mbledhja e të dhënave bëhet nga mjekja trajtues / mjeku trajtues në kuadrin e trajtimit tuaj. Nga ana tjetër, ne marrim edhe të dhëna nga mjeket e tjera / mjekët e tjerë dhe personeli shëndetësor, tek të cilët ju ishit ose jeni në trajtim, nëse ju e keni dhënë pëlqimin tuaj për këtë. Në historinë tuaj të shëndetit përpunohen vetëm të dhëna, të cilat kanë lidhje me trajtimin tuaj mjekësor. Historia e shëndetit i përfshin të dhënat personale të bëra në formularin e pacientit, si të dhënat personale, të dhënat e kontaktit dhe të dhënat për sigurimin, si dhe, ndër të tjera, bisedën sqaruuese të zhvilluar në kuadrin e trajtimit, të dhënat e mbledhura shëndetësore si anamnezat, diagnozat, sugjerimet e terapisë dhe përfundimet.

Transferime të të dhënave që kërkojnë pëlqimin

Parimisht, përpunimi i të dhënave bëhet në mënyrë të mbështetur në arsyen ligjore të dokumentimit të historisë së sëmundjeve si dhe në detyrimin e ruajtjes dhe faturimit duke e përfshirë inkasimin. Ne i transmetojmë të dhënat tuaja personale dhe në veçanti të dhënat tuaja mjekësore palëve të treta të jashtme vetëm, nëse kjo lejohet ose kërkohet me ligj ose nëse ju gjatë trajtimit tuaj keni dhënë pëlqimin tuaj për përcjelljen e të dhënave.

- Transmetimi për sigurimin tuaj shëndetësor ose për sigurimin e kundër aksidenteve ose invaliditetit bëhet me qëllim të faturimit të shërbimeve të ofruara për ju. Lidhur me këtë, lloji i të dhënave të transmetuara orientohet në përcaktimet ligjore.
- Përcjellja e mëtejshme autoriteteve kantonale si dhe kombëtare (p.sh. shërbimi mjekësor i kantonit, departamente të shëndetësisë etj.) bëhet në bazë të detyrimeve ligjore për njoftimose dispozitave të tjera logjore.
- Përcjellja e mëtejshme e të dhënave të nevojshme për pacientin dhe faturën për zyrën e inkasimit bëhet me qëllimin e inkasimit (mbledhja e kërkesave të parave që duhen paguar).

Kohëzgjatja e ruajtjes

Parimisht, historia shëndetësore ruhet 20 vjet pas mjekimit tuaj të fundit. Me dëshirë të shprehur qartë, ky dokumentacion mund të asgjësohet pas mbarimit të kësaj kohe, përndryshe ruajtja mund të bëhet edhe pas 20 vitesh. Në rast të veçantë, në varësi nga mjekimi juaj dhe pëlqimi juaj përkatës, transmetimi i të dhënave do t'u bëhet marrësve të tjerë të autorizuar (p.sh. laboratorëve, mjekëve të tjera / mjekëve të tjerë, therapeuteve / therapeuteve).

Revokimi i pëlqimit

Me ligj mjekët dhe terapeutët janë të detyruar që t'i ruajnë të dhënat tuaja dhe historinë tuaj të sëmundjeve. Një revokim i mundshëm i pëlqimit tuaj është në kundërshtim me këtë detyrim ligjor. Kjo vlen gjithashtu për përpunuesit e të dhënave, të cilët janë përmendur më lart nën marrësit. Kjo do të thotë që përpunimi i të dhënave personale në kuadrin e mjekimit dhe terapisë mjekësore parashikohet gjithashtu me ligj (MedBG [Ligji për profesionet mjekësore], KVG [Ligji i sigurimit shëndetësor] dhe ligjet shëndetësore kantonale), ku përgjegjësit dhe marrësit si persona ndihmës të lidhur janë gjithashtu të detyruar me ligj që të ruajnë fshehtësinë (neni 62 DSG [Ligji për mbrojtjen e të dhënave] dhe neni 321 StGB [Kodi Penal]). Për përcjelljen më tej të të dhënave të anonimizuar vlen neni 31 lit. e) DSG pa asnjë kufizim. Nëse ju dëshironi megjithatë të revokoni plotësisht ose pjesërisht një pëlqim tashmë të dhënë, kjo duhet të bëhet me shkrim. Nëse përpunimi i të dhënave nuk mund të bazohet në ndonjë bazë tjetër ligjore përveç pëlqimit, përpunimi do të ndërpritet. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave të bëra deri në revokim mbetet e paprekur nga revokimi.

Njoftim, shikim dhe dorëzim

Ju keni të drejtë të merrni njoftim për të dhënat tuaja personale. Ju mund ta shikoni historinë shëndetësore ose mund të kërkonti edhe një kopje. Mënyra e dhënies përcaktohet nga ofruesi juaj i shërbimit. Ai/ ajo mund të parashikojë një formular për këtë qëllim. Dorëzimi i kopjes mund të jetë me shpenzime. Shpenzime të mundshme, të cilat varen nga harxhimi i përgatitjes së kopjes, do t'ju njoftohen paraprakisht.

E drejta për transmetimin e të dhënave

Ju keni të drejtën, të dhëna, të cilat ne i përpunojmë në mënyrë të automatizuar respektivisht në mënyrë digjitale, t'ju dorëzohen juve ose një pale të tretë në një format të zakonshëm, të lexueshëm me kompjuter. Kjo vlen veçanërisht për përcjelljen më tej të të dhënave mjekësore te një profesionist shëndetësor të zgjedhur nga ju. Nëse ju kërkonti një transferim direkt të të dhënave në një person tjetër përgjegjës, kjo bëhet vetëm për atë që është e mundur teknikisht.

Korrigjimi i të dhënave tuaja

Nëse ju konstatooni ose jeni të mendimit që të dhënat tuaja nuk janë të sakta ose janë të paplota, ju keni mundësi që të kërkonti korrigjimin e tyre. Nëse nuk mund të konstatohet as saktësia, as paplotësia e të dhënave tuaja, ju e keni mundësinë e vendosjes së një shënimi të kontestimit.